



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË  
FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE DHE SHKENCAVE HUMANE**

**RAPORT I VLERËSIMIT  
TE BRENDSHËM  
PËR AKREDITIMIN E PROGRAMEVE TË CIKLIT TË PARË  
BACHELOR DHE TË DYTË MASTER NË  
FAKULTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS DHE  
SHKENCAVE HUMANE**

**NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË**

**EMËR MBIEMËR**

Dr. Maria Dojçe

Msc. Lorena Kelo

Msc. Blendi Baze

Dr. Desareda Mero

Klodiana Dhëmbi (student)

Departamenti i Shkencave Sociale

Departamenti i Matematikës, Informatikës, Fizikës

Departamenti i Infermierisë

Departamenti i Biologji-Kimisë

Departamenti i Matematikës, Informatikës, Fizikës

**VITI AKADEMIK 2016– 2017**

## TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE .....	3
I MISIONI DHE OBJEKTIVAT E FAKULTETIT .....	4
II - STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT.....	18
ORGANOGRMA .....	22
III - ANALIZA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE DIPLOMAVE .....	22
IV - PROGRAMET E STUDIMIT, ORGANIZIMI I KURRIKULAVE, KREDITET .....	25
V - STAFI MËSIMDHËNËS DHE MBËSHTETËS.....	27
VII - KËRKIMI SHKENCOR.....	40
VIII - STUDENTËT .....	41
BURIME MATERIALE. LOGJISTIKA.....	42
X - FINANCIMI DHE MENAXHIMI I BURIMEVE FINANCIARE .....	43
XI - SISTEMI I BRENDSHËM I SIGURIMIT TË CILËSISË.....	43
XII - BASHKËPUNIMI KOMBËTAR, NDËRKOMBËTAR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN.....	43
XIII. ANALIZA SWOT E FAKULTETIT . . . . .	44
ANALIZA SWOT.....	44

## HYRJE

Ky raport u realizua në kuadër të procesit vjetor të vlerësimit të brendshëm të cilësisë për programet e studimit në ciklin e parë “Bachelor” dhe të ciklit të dytë “Master” në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Raporti u realizua nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për fakultetin përkatës.

Qëllimi i këtij procesi është identifikimi i strategjive të suksesshme, problematikave dhe mangësive të mundshme gjatë procesit mësimor për vitin akademik 2016-2017. Ky raport synon të sigurojë një vlerësim korrekt, të bazuar në tregues realë dhe të matshëm të nivelit të arritjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit të përfshirë në vlerësim, të përgatisë një raport i cili do të shërbejë si bazë për grupin e vlerësimit të jashtëm, gjatë procesit të akreditimit.

Për të përmbushur me sukses këtë qëllim, GVB është bërë pjesë e trajnimeve paraprake të organizuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Universitetit, mbi bazën e përvojës së vlerësimeve të mëparshme, duke hartuar edhe një plan pune, duke ndarë detyrat dhe duke udhëzuar GVB për përmbushjen e detyrave.

Gjithashtu, për hartimin e këtij raporti, GVB organizoi takime me stafin akademik, administrativ, atë mbështetës si dhe studentët e fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Humane.

Në këtë raport u shfrytëzuan të gjitha materialet e sekretarisë mësimore, të dhënat arkivore për fakultetin, qëndrimet dhe vlerësimet e studentët për procesin mësimor, për stafin akademik, për infrastrukturën.

Dokumentacioni bazë, mbi të cilin u mbështet procesi i Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane:

- Ligj nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë
- Manuali i Vlerësimit Institucional të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri, 2016 - 2017
- Manual për Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit, APAAL 2015
- Raporti i analizës vjetore realizuar nga dekanati i Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
- Udhëzimet e MAS-it
- Dokumente të veprimtarisë institucionale të Universitetit “Fan S. Noli”, më konkretisht:
- Statuti i UK-së,
- Rregullore e UK-së,
- Rregullore e Programeve të studimit
- Rregullore e transferimeve

- Planet mësimore
- Syllabuset e lëndëve

## I MISIONI DHE OBJEKTIVAT E FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE

### **Historiku i Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane**

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, në vitin akademik 2011-2012, u përcaktua si një njësi e re dhe tepër e rëndësishme e Universitetit “Fan S. Noli” Korçë. Në zbatim të Urdhërit nr. 16, datë 17.1.2012 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës dhe në nenin 41 të Ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” u bë riorganizimi i Fakultetit të Mësuesisë i themeluar në vitin 1992, në dy Fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
2. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane ka në përbërje të tij tre Departamente, dhe dy grupe mësimore - kërkimore: një grup mësimor - kërkimor të atashuar në Departamentin e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës si dhe një grup mësimor kërkimor të atashuar në Departamentin e Infermierisë.

Fakulteti ka një bashkëpunim shumë të frytshëm me disa fakultete homologe në Rajon dhe në Europë. Përmendim këtu Universitetin Kirili e Metodi, Maqedoni; Universitetin Aristoteli, Selanik, Greqi; Universitetin e Prishtinës; Universitetin e Sofies, Bullgari etj. Në këto Universitete, pedagogë të ndryshëm kanë realizuar kualifikime afatshkurtra dhe afatgjata, duke përfituar nga eksperiencia e tyre. Ndërkohë, disa studentë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, kanë realizuar dhe punimet e diplomave të tyre në këto Universitete.

Të gjitha këto janë kyçi i suksesit tonë në përgatitjen e profesionistëve në fushën e Sociologjisë, mësuesve profesionistë të Filozofisë dhe Sociologjisë, të Matematikës dhe Fizikës, të Biologji - Kimisë, profesionistëve të Teknologjisë së Informacionit dhe Infermierëve të përgjithshëm dhe Mami, të një niveli të lartë shkencor, me dije bashkëkohore dhe me mundësi punësimi shumë të larta.

Reforma më e madhe arsimore e kryer së fundmi është strukturimi i programeve të studimit në përputhje me parimet e hedhura në Deklaratën e Bolonjës dhe në të gjitha dokumentat e tjera pasuese, të cilat gjejnë pasqyrimin e tyre në Ligjin Nr.9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në amendamentet e pasqyruara në ligjin Nr.10307, datë 22.07.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9741”, datë 21.05.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kështu sot në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, arsimimi i lartë është i organizuar në dy cikle, duke ofruar dy nivele diplomash; lëndët janë të organizuara në module dhe ngarkesa e tyre shprehet në kredite; programet e studimit janë të gjitha bashkëkohore. Ato ndjekin programet e studimit të fakulteteve homologe, kryesisht të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Fakultetit të Shkencave Sociale, në Universitetin e Tiranës, por edhe të Rajonit. Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diploma përkatëse dhe suplementin e diplomës; studentët kanë mundësinë e transferimit të krediteve nga një Institucion tjetër i Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, si dhe të pajisen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për tu larguar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane në një IAL tjetër.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane ka pësuar përmirësime dhe zhvillim edhe në drejtimin institucional, duke u organizuar mbi bazën e Departamenteve dhe funksionimin e

organeve kolegjiale në vendimmarrje. Kështu në Fakultet funksionon normalisht Këshilli i Fakultetit, i cili është organ kolegjial vendimmarrës. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit, shkalla e gjerë dhe e balancuar e përfaqësimit, funksionet që kryen dhe autoriteti vendimmarrës të shprehura në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloren e brendshme të Fakultetit garantojnë një autonomi të brendshme institucionale në menaxhimin e Fakultetit dhe të njësisve të tij bazë.

Në Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane është shtuar dhe Qendra e Ekselencës, Mbështetur në udhëzimet e MASH, Urdhër nr. 110, dt. 09.03.2011 për: “Nevojat për Trajnimin e Mësuesve dhe Drejtuesve të Arsimit Parauniversitar”, e cila përbën një njësi bazë, kërkimore dhe trajnuese. Kjo qendër ka si mision të vetin, formimin cilësor të specialistëve në fushat përkatëse dhe promovimin e kërkimit shkencor në shkencat e natyrës dhe ato humane. Ajo funksionon si njësi trajnuese dhe kërkimore në fushën e Didaktikës së Shkencave, e çertifikuar dhe akredituar nga MASH.

Krahas përqëndrimit të veprimtarisë kërkimore të Fakultetit, Qendra e Ekselencës zhvillon një aktivitet të gjerë trajnues duke ofruar programe për mësuesit në shërbim në Rajonin e Korçës dhe më gjerë, në fushat:

- a. Drejtim dhe administrim i shkollës;
- b. Shkenca sociale: Filozofi, Sociologji;
- c. Shkencat natyrore: Matematikë, Fizikë, Informatikë, Biologji, Kimi,

Këto programe trajnimi synojnë zhvillimin e shprehive në mësimdhënie, të praktikave mësimore, si dhe të aftësive të drejtimit për personelin në detyrë.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane ka patur një dinamikë të lartë zhvillimi në vitet e fundit: në drejtim të zhvillimit të programeve në të dy ciklet e studimit, duke krijuar programe krejtësisht të reja dhe rikompozim të përgjithshëm, të kujdesshëm të atyre ekzistuese në përputhje me kërkesat e reformës së Bolonjës dhe në drejtim të rritjes së numrit të studentëve, rritjes së stafit akademik në numër dhe në kualifikim dhe të atij ndihmës.

### **Objektivat e përgjithshme:**

Objektivat e programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane janë në vijimësi dhe mbështetje të qëllimit dhe objektivave të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane dhe Universitetit Fan S Noli, Korçë. Me konkretisht për vitin akademik 2016-2017 ka synuar këto objektiva:

### **Të sigurojë ecurinë dhe zhvillimin e programeve të studimit të licënuara të departamenteve pwrkatwse.**

Për vitin akademik 2016-2017 në Departamentin e Shkencave Sociale u zhvilluan: 2 programe të ciklit të parë Bachelor dhe 2 programe studimi Master Profesional.

Në këtë vit u çel cikli i studimit **Master Profesional në “Administrim publik”**, duke mundësuar dhe vazhdimësinë për studentët e programit të studimit Administrim dhe Politika Sociale.

Programi Master Shkencor nuk zhvilloi vitin e parë për 2016-2017, por vetëm siguroi mbrojtjen e diplomës për katër studentët e viteve të mëparshme.

Ndwrsa nw departamentin e Biologji-Kimisw u zhvillua programi Master Profesional nw  
,,,,,,,,,,,,,,,,,,,,,

### **Disa nga objektivat ky#e tw deprtamenteve pwrbrwse tw kwtij fakulteti janw:**

## **Të sigurojë plotësimin e kuotave të propozuara për të gjitha programet e studimit dhe të përmirësojë cilësinë e kandidatëve aplikues dhe fitues**

Nëpërmjet promovimit të programeve të studimit, që diplomojnë studentë me kompetenca për tregun e punës.

Nëpërmjet krijimit të një ambienti pune, dhe kërkimi shkencor, ku theksohet bashkëpunimi mes kolegëve, dhe përrshirja e studentëve në aktivitetet e departamentit. Konkretisht në këtë vit, 2016-2017 shënojmë rritje të mesatares së përgjithshme të studentëve në të dy programet bachelor, krahasuar me dy vitet e mëparshme.

Në këtë vit u shënuar një ulje në numrin e kandidatëve të regjistruar sidomos kjo në programin e studimit bachelor: Filozofi – Sociologji (vetëm 17 studentë të rregjistruar).

Në programet e tjera plotësimi i kuotave është më i stabilizuar.

**Të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies** duke e vlerësuar si një element shumë të rëndësishëm të ecurisë së programeve dhe rezultateve të studentëve.

Konkretisht në kuadër të sigurimit të kurrikulave cilësore në programet e studimit të ciklit të parë bachelor, dhe të programeve master profesional dhe master shkencor, realizoi:

- Rishikim të kurrikulës dhe të çdo lënde dhe moduli për të qënë sa më koherentë me zhvillimet, dijen e re dhe literaturën aktuale. Kjo për të pajisur studentët me dije të qëndrueshme dhe kompetitive.
- U rishikuan struktura e ndërtimit të lëndëve dhe moduleve në këto programe studimi në shërbim të pajisjes së studentëve me kompetenca shkencore dhe profesionale
- U synua nxitja e mendimin kritik dhe përgjegjshmërisë qytetare tek studentët për të bërë universitetin një institucion demokratik të arsimit. Përrshirja e studentëve në aktivitete të përbashkëta (seminari shkencor në ditën e europës), dhe nxitja për funksionimin e grupi i debatit, etj.
- Ristrukturimi i programit të studimit master profesional në mësuesi në zbatim të ligjit të arsimit të lartë. Gjatë vitit akademi 2016-2017, pikërisht në periudhën shkurt prill organizoi takime dhe bisëda me kolege e specialistë të universitetit të Elbasanit serisht në detyrim të ligjit të arsimit të lartë mbi programet e ngjashme në mësuesi. Në qershor të 2017 prezantoi në departament dhe dekanat planin mësimor të ristrukturuar: Master në mësuesi për arsimin e mesëm në filozofi dhe shkenca sociale, 120 ECTS, me kohëzgjatje 2 vjet.
- Hartoi strategji të reja për rihapjen e programit Master Shkencor në Filozofi Sociale për vitin 2017-2018

**Të nxitë kërkimin shkencor dhe kooperimin në fusha të përbashkëta kërkimi në departamente.**

**Studimi e tregut** për të qënë në gjendje për të lexuar kërkesat e tregur dhe shoqërisë, drejtuar universitetit. U realizua studimi i tregut për hapjen e programi të studimit master profesional në administrim publik.

Mbetet sërisht një çështje e hapur dhe e domosdoshme për t'u zhvillur dhe thelluar edhe në vitet në vazhdim. Kjo do të pasojë dhe me hartimin dhe propozimin për hapjen e programeve të reja të studimit në përgjigje të nevojës dhe kërkesës së tregut.

## **PROGRAMET E STUDIMIT QË OFROHEN:**

### **PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR”, 180 KREDITE (ME KOHË TË PLOTË)**

**Programet e studimit Bachelor që ofron Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane:**

#### **- Bachelor në Filozofi-Sociologji**

Programi i studimit Bachelor në Filozofi-Sociologji është me kohë të plotë, ka kohëzgjatje normale bazuar në Konventën e Bolonjës, 3 vite akademike, gjatë të cilave realizohen 180 kredite në total. Këto vite akademike organizohen në 6 semestra me 15 javë mësimore secila (pa javët e sezonit të provimeve).

Ky program studimi synon që studenti:

- Të pajiset me njohuri bazë të fushën e filozofisë dhe të historisë së mendimit filozofik.
- Të njohë dhe të kuptojë, teoritë kryesore në fushën e sociologjisë, të moralit dhe të politikës.
- Të pajisë studentët me aftësi të përgjithshme për studimin e shkencave humane.
- Të aftësojë studentët në zhvillimin e kompetencave, për t`ju përgjigjur pozitivisht sfidave të studimeve të ciklit të dytë.
- Të aftësojë studentët në komunikim, zgjidhje problemore, punën në grup dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit, aftësi të nevojshme në formimin e tyre si specialistë në fushën e filozofisë dhe sociologjisë.
- Të formohet nga pikpamja shkencore dhe profesionale me terma, nocione dhe koncepte në fushën e Filozofisë dhe Sociologjisë.
- Të aplikojë konceptet teorike themelore duke përdorur metoda shkencore e mjete të përshtatshme.

#### **Bachelor në Administrim dhe Politika Sociale**

Ky program studimi ka kohëzgjatje normale 3 vite akademike, gjatë të cilave realizohen 180 kredite. Këto vite akademike organizohen në 6 semestra me 15 javë mësimore secila (pa javët e sezonit të provimeve).

Programi i ciklit të parë Administrim dhe Politika Sociale, synon të realizojë formimin akademik të studentëve, aftësimin profesional në lidhje me administrimin dhe politikat sociale, si dhe kualitetet që kërkon tregu i punës.

Konkretisht, nëpërmjet këtij programi i studimit të ciklit të parë synohet në:

- Formimin e studentëve të kualifikuar me njohuri dhe kapacitete të nevojshme në fushën e administrimit dhe politikave sociale.

- Pajisjen me njohuritë teorike, prezantimin e metodave dhe instrumentave të analizës së fenomeneve me të cilat përballet administrata publike, për t'ju përgjigjur kërkesave të reja në kushtet e zhvillimit të shoqërisë shqiptare në kuadrin e integritit në strukturat politike dhe sociale të BE.
- Përgatitjen e studentëve me vizionin dhe aftësitë e duhura në lidhje me përmirësimin e mekanizmave dhe institucioneve të politikave sociale, duke formuar burime njerëzore të kualifikuara në këto shërbime.
- Formimin e studentëve me elementët bazë të etikës profesionale në sferën e shërbimeve sociale duke përmirësuar marrëdhënien dhe komunikimin social si faktorë të rëndësishëm në përmbushjen e nevojave shoqërore

#### **- Bachelor në Matematikë – Fizikë**

#### **- Bachelor në Matematikë – Informatikë**

Struktura e programeve Bachelor në degët Matematikë-Fizikë dhe Matematikë-Informatikë është organizuar në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar të arsimit të lartë, duke ofruar programe të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Mësimdhënia në këto dy degë përqëndrohet në njohuritë dhe metodat më të mira bashkëkohore duke u bazuar në një literaturë moderne e të asimilueshme, për ta bërë studentin pjesë aktive të procesit mësimor.

- Një ndër objektivat kryesore të programeve Bachelor në Matematikë-Fizikë dhe Matematikë-Informatikë është edukimi dhe formimi i mësuesve të ardhshëm në fushën e Matematikës dhe Fizikës si dhe kualifikimi i mëtëjshëm i tyre.
- Programet paraqiten dhe organizohen me standarte cilësore për të përcjellë të gjitha njohuritë e nevojshme që synojnë përgatitje sa më të plotë profesionale në mësimdhënien e Matematikës, Fizikës dhe Informatikës.
- Aftësimi i studentëve për të zhvilluar aftësitë e të menduarit kritik, për të komunikuar qartë, për të kuptuar dimensionet etike të vendimeve që ata marrin, për të njohur rolin dhe rëndësinë që ka matematika, mësimdhënia e saj dhe profesioni i mësuesit në zhvillimin e shoqërisë.

#### **- Bachelor në Teknologji Informacioni**

Diplomimi në programin Bachelor në Teknologji Informacioni, përbën një dëshmi të kualiteteve të mëposhtme për studentët, duke i bërë ata:

- Të kuptojnë rrugët për përcaktimin, implementimin, përdorimin dhe menaxhimin e teknologjive të informacionit për një gamë të gjërë organizatash. Qendra e vëmendjes është në rëndësinë e të menduarit logjik dhe nevojës për perfeksionimin e aftësive teknike.



- Të kenë aftësi për zbatimin dhe menaxhimin e teknologjisë së informacionit në jetën civile, sociale dhe profesionale.
- Të kenë aftësi për të kuptuar, zhvilluar dhe implementuar sistemet softëer-ike në mënyrë të strukturuar dhe efektive.
- Të aftësohen në identifikimin e mekanizmave për zhvillim të vazhdueshëm profesional të nevojshëm për gjatë gjithë jetës.
- Të fitojnë aftësi komunikuese dhe interpretuese.
- Të demonstrojnë aftësi për të punuar si individ nën udhëheqje, apo lider grupi.

### - Bachelor në Biologji – Kimi

Duke u mbështetur në nenin 25 të Ligjit për Arsimin e Lartë Nr.9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar si dhe tek udhëzimi 15 datë 04.04.2008 i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, gjatë vitit akademik 2013-2014 u hap programi i studimit për Ciklin e Parë Biologji-Kimi me kohë të pjesëshme. Çelja e këtij programi studimi përligjet jo vetëm nga tradita që ka Rajoni i Korçës për profilin e mësuesisë, por edhe nga misioni që kanë universitetet rajonale për përgatitjen e mësuesve, për sistemin e arsimit bazë.

Programi i studimit të Ciklit të Parë “Biologji-Kimi” me kohë të pjesëshme realizohet me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tij është 4 (katër) vite akademike.

### - Bachelor në Infermieri e Përgjithshme

### - Bachelor në Mami Infermier

Departamenti i Infermierisë ofron programe studimi të ciklit të parë në fushat e studimit: Infermier i Përgjithshëm dhe Infermier Mami. Këto programe realizohen me 180 kredite me kohëzgjatje tre vjeçare (koha e plotë) dhe katër vjeçare (koha e pjesëshme). Programet ofrojnë njohuri bazë mbi metodat e parimet shkencore të përgjithshme dhe aftësi të veçanta profesionale në fushën e infermieristikës. Në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë lëshohet *Diplomë Bachelor* në fushën e studimit të kryer.

Emërtimi i programit të studimit	Vendime
Filozofi - Sociologji	Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr. 22007/2, datë 17.06. 2002
Administrim dhe Politika Sociale	Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr. 3167/2 datë 04.04. 2013
Matematikë - Fizikë	Vendimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Nr. 833, datë. 04.06.2008
Matematikë Informatikë	Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr. 833 datë 04.06. 2008

Teknologji Informatik	Vendimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Nr 518, datë 30.06.2010
Biologji - Kimi	1.Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr.352, datë 12.05.2010 2. Vendimi i Senatit akademik të Universitetit "Fan S. Noli" Vendimi Nr.11, datë 16.03.2010 3. Vendimi i Këshillit të Fakultetit:Vendimi Nr.4, datë 23.09.2013 Miraton ndryshimet në planin mësimor të deges Biologji-Kimi
Infermieri e Përgjithshme	Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr.369, datë 10.07.1995
Mami Infermier	Vendimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Nr 5353, datë 22.08.2005

## **PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL", 90 KREDITE (ME KOHË TË PLOTË)**

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane ofron programet e studimit:

### **Mësuesi për arsimin e mesëm në shkencë sociale me profil minor në "Edukim Qytetar dhe Demokratik"**

Ky program studimi ka kohëzgjatje normale 1.5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik, gjatë të cilit realizohen 90 kredite. Në përfundim të këtij cikli studimesh lëshohet diplomë "Master Profesional" në "Filozofi-Sociologji" me profil minor në "Edukim Qytetar". Ky program studimi synon formimin shkencor dhe intelektual të studentëve në fushën e Filozofisë dhe Sociologjisë. Në përfundim të këtij programi, studentët do të gjejnë mundësi punësimi në arsimin parauniversitar.

### **Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Matematikë - Fizikë me profil minor në "Informatikë"**

Qëllimi i programit të studimit:

Misioni i programit Master Profesional në Matematikë-Fizikë me profil minor në Informatikë është në përputhje me misionin e institucionit për edukim cilësor në shërbim të shoqërisë. Ky program ka si objektiva të tij zhvillimin profesional në terma afatgjatë: aftësim të mësuesve për zgjidhjen e nevojave të ndryshme; përmirësim dhe fuqizim të shkollave në drejtim të mësimdhënies. Programi i studimit i aftëson mësuesit të zgjidhin nevoja të ndryshme të nxënësve dhe i ndihmon për të përmirësuar mësimdhënien si në cilësi ashtu edhe në metodologji.

Objektivat e programit të studimit:

- Përgatitja, edukimi dhe formimi i individëve të aftë në mësimdhënien e lëndëve të matematikës, fizikës dhe informatikës në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës.
- Formimi i specialisteve të pajisur me njohuritë e duhura dhe me arritjet e fundit në fushën e shkencave.
- Kryerjen e studimeve shkencore për të zhvilluar e çuar më tej progresin në përgatitjen e specialistëve.
- Thellimi dhe zhvillimi i mëtejshëmi i kompetencave profesionale të mësuesve të ardhshëm, duke i pajisur me njohuritë shkencore të kohës.
- Mbështetja dhe përgatitja e studentëve të talentuar në punën e tyre kërkimore shkencore
- Nxitja e studentëve që nëpërmjet projekteve individuale apo në grup të studiojnë probleme të ndryshme shkencore brenda fushës së tyre.

### **-Mësimdhënie për Mësuesit e Biologji – Kimisë**

Ky program studimi u çel gjatë vitit akademik 2013-2014, mbështetur në udhëzimet e Ministrisë të Arsimit nr.4, datë 22.1.2008, nr.15, datë 04.04.2008, dhe udhëzimin e datës 22.6.2010 për programin e Masterit Profesional në Mësimdhënie.

#### ***Qëllimi i programit të studimit***

Programi i studimit ka për qëllim:

- Të përgatitë mësimdhënës të suksesshëm, me aftësi të thella profesionale në fushën e **biologji–kimisë**, cilësi të larta morale dhe shoqërore për t’u kthyer në modele frymëzuese dhe motivuese për nxënësit.
- Të përgatitë mësimdhënës me njohuri bazë dhe të avancuara në fushat kryesore të **biologjisë dhe kimisë**, të aftësuar me njohuritë kryesore pedagogjike, kulturore dhe metodike për ti bërë mësues të mire profesionistë për të ardhmen.
- Të përgatitë mësimdhënës si njerëz të aftë për të punuar dhe për të ndihmuar në komunitet.
- Të përgatitë mësimdhënës të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e rajonit dhe më gjerë për të ndihmuar në zhvillimin e tyre, rritur cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve.

#### ***Programi i studimit suksesin e tij e bazon:***

- në kompetencën dhe eksperiencën e stafit akademik, dhe ndihmes, një staf me një përvojë të gjatë në fushat e **biologjisë dhe kimisë**.
- në eksperiencën akademike prej 44 vjetesh në lëndet dhe modulet e **biologjisë dhe kimisë** që ka Universitetit “Fan S. Noli” i Korçës.
- në infrastrukturën moderne në pergjithësi dhe laboratorët bashkëkohorë të **biologjisë dhe kimisë** që janë ngritur për këtë qëllim pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane,
- në përvojën e fituar gjatë viteve në zhvillimin e programeve Master i Nivelit të Parë në Mësuesi dhe Master Profesional në Mësuesi,

- Në rezultatet e mira të studentëve të programit Biologji–Kimi në ciklit të parë të studimeve në Fakultetin të Shkencave Naturore dhe Humane të Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës.
- Në kerkesën e madhe që ka tregu rajonit të Korçës për këta specialiste.

***Objektivat e përgjithshme të programit të studimit:***

Objektiva të përgjithshme që ka ky program studimi, janë:

- T’ju japë të diplomuarve arsimin dhe trajnim të mëtjshëm profesional në fushën e mësimdhënies së **Biologji–kimisë**;
- T’ju krijojë studentëve një pamje të re për arsimin në Shqipëri, në përputhje me përvojën dhe konceptet evropiane;
- Të përpiqet për të realizuar një status të ri të mësuesit në kushtet e reja ekonomiko-shoqërore që janë krijuar;
- Programi do të shtrojë alternativa konkrete për zhvillimin e arsimit në fushën e mësimdhënies së **Biologji–kimisë** në bazë të strategjisë kombëtare dhe të japë ndihmesën e vet për hedhjen dhe konsolidimin e bazave për një arsim sa më profesionist.
- Objektivi final i programit është që të përgatitë specialistë të zotë në fushën e mësimdhënies së **Biologji–kimisë** që të thithen nga tregu i punës, qoftë në sektorin arsimor shtetëror e privat, ashtu edhe në sektorin privat industrial e ushqimor si specialistë trajnues i probelematikave **kimike e biologjike** probleme që shtrohen me forcë dhe janë të detyrueshme nga standartet e B.E dhe Republikës së Shqipërisë.

***Objektiva formuese të disiplinave:***

Objektivat formuese të disiplinave që ka ky program studimi janë:

- Pajisja e studentëve me njohuri të përshtatshme teorike dhe shprehje praktike për arritjen e standardeve të larta në mësimdhënie në fushën e **biologji–kimisë**, duke zbatuar teoritë dhe praktikën e arsimit në lidhje me karakteristikat e grup moshave, përparësitë e arsimit në vendin tonë dhe rolin e mësuesit si profesionist në një kontekst social në ndryshim të vazhdueshëm;
- Pajisja e studentëve me njohuri bazë të kërkimit. Nëpërmjet lëndës së Kërkimit Shkencor do të pajisen me metodologjitë e kërkimit dhe të hulumtimit shkencor, të metodave kryesore në kërkimin biologjik, kimik dhe kërkimin në fushën e edukimit, ç’ka do të bëjë që ata të jenë në gjendje të zbatojnë kërkimin shkencor në klasat ku do të zhvillojnë mësim.
- Pajisja e studentëve me njohuri për mënyrën e mësimdhënies të kimisë në shkollë me larmishmërinë e formave në klasë, laborator dhe jashtë shkolle.
- Pajisja e studentëve me njohuri bazë të planifikimit dhe të mësimdhënies në kimi, format e organizimit të procesit mësimor, metodat e mësimdhënies së biologjisë dhe kimisë, planifikimi vjetor dhe ditor i mësimdhënies, me metodat

bashkëpunuese të mesimdhënies, diskutimit, debateve, vrojtimit, eksperimentimit si dhe punëve praktike.

- Zhvillimi i aftësive praktike dhe profesionale të studentëve në teknikat e laboratorit dhe eksperimentit në biologji dhe kimi duke përdorur metoda që sigurojnë një përvetësim aktiv të njohurive të marra në teori aftësive komunikuese në seminare dhe në praktikën mësimore të vëzhguar në shkollë.
- Paraqitja dhe përpunimi i metodave dhe mënyrave të ndryshme të mesimdhënies për një mësim aktiv dhe gjithëpërfshirës.
- Aftësimi i studentëve për zgjidhjen e situatave problemore në arsim në kontekste të ndryshme.
- Sigurimi i një konteksti akademik për diskutimin e çështjeve që lidhen me mesimdhënien e lëndëve, me synim zhvillimin e perspektivës teorike të studentëve dhe edukimin e kompetencave specifike për secilën lëndë. Njohja me zhvillimet më të fundit në fushën e mesimdhënies së këtyre lëndëve dhe aftësimin e tyre për komunikimin dhe teknologjitë e informacionit bashkëkohor.
- Realizimi i përgatitjes profesionale të studentëve duke u përqëndruar në çështje të tilla si testimi, menaxhimi, strategjitë e të nxënësve, punë kërkimore dhe të mësuarit për gjatë gjithë jetës.
- Një objektiv tjetër i rëndësishëm është që t’ju jepet studentëve një përvojë profesionale në njohjen e institucionit arsimor për të cilin ata përgatiten, për mënyrën e komunikimit dhe menaxhimit të klasës, në didaktikën e mesimdhënies, vlerësimin të nxënësve etj. Këtij qëllimi i shërben më së miri edhe ngritja pranë Fakultetit tonë e Qendrës së Ekselencës, e cila do të jetë një mbështetje e fuqishme për mesimdhënësit e ardhshëm;
- Një objektiv tjetër është pajisja e studentëve me njohuri metodologjike të Edukimit Shëndetësor. Kjo synon t’ju japë studentëve njohuri mbi konceptet bazë të shëndetit si dhe faktorët përcaktues të tij.
- Ruajtja e vlerave kulturore kombëtare, standardeve mjedisore biologjike dhe kimike, biodiversitetit dhe interesave kombëtare.

***Objektivat për aftësimin praktik të studentëve janë:***

- Të sigurojë cilësinë e mesimdhënies nga mësuesit e rinj të biologjisë dhe kimisë dhe performancë të lartë të profesionit të mësuesit nëpërmjet praktikës profesionale në shkollat më të mira 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit nën drejtimin e mësuesve “Mentor” të biologjisë dhe kimisë dhe pedagogëve të Fakultetit, me qëllim vënien në praktike të teorisë, të metodave dhe teknikave të mesimdhënies.

- Të sigurojë zhvillimin e kapaciteteve të mësuesve të ardhshëm për një përshtatje më të mirë ndaj ndryshimeve të kurrikulës, mësimdhënies si dhe komunikimit dhe normave të etikës e të sjelljes së mësuesit.
- Të sigurojë përvetësimin e mëtejshëm të njohurive teoriko-profesionale, dhe të aftësive e shprehive praktike në fushën **eksperimentimeve laboratorike të biologjisë dhe kimisë** duke dhënë njëkohesisht dhe eksperiencën e përfutur gjatë studimeve në këtë program masteri.
- Në fund të praktikës mësimore, studentët vlerësohen nga mësuesit “Mentor” të biologjisë dhe kimisë dhe nga drejtorja e shkollës përkatëse, ku kanë zhvilluar praktikën mësimore.

***Objektivat për hartimin e tezës së diplomës:***

- Në përfundim të studimeve çdo student paraqet një punë kërkimore në formën e një teze diplome me 10 kredite përmes së cilës synohet që studenti të zhvillojë aftësitë e konceptimit, të analizës dhe të interpretimit në fushën e metodologjisë mësimdhënies së biologjisë dhe kimisë, problematikave rajonale në fushën biologjike dhe kimike, si dhe të shkrimit dhe të paraqitjes së saj.
- Të njihet me metodologji të ndryshme kërkimore në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe eksperimental në **biologji–kimi** përmes seminarit kërkimor që ka ky program i masterit.
- Zhvillimin e teknikave të kërkimit shkencor dhe eksperimental në fushën e **biologji–kimisë** dhe nxjerrjes së informacionit të domosdoshëm në këto fusha duke shfrytëzuar laboratorët bashkëkohore që ka në dispozicion Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane dhe Fakulteti i Bujqësisë të Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës.
- Zhvillimin e shprehive dhe aftësive të transferueshme të nivelit më të lartë në kërkimin shkencor dhe interpretimin e të dhënave.
- Zhvillimin e shprehive të mendimit kritik, si dhe të vlerësimit të të dhënave dhe informacionit në fushat e **biologji–kimisë**, të interesave profesionale të studentëve të lidhura me mësimdhënien në këto fusha.
- Ndërgjegjësimin e studentëve në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të përgjegjësive të tyre personale në përfshirjen në punë të pavarur kërkimore-shkencore, si dhe vlerësimin kritik të informacionit dhe të dhënave dhe konkluzioneve të kërkimit shkencor dhe eksperimental në fushat e **biologji–kimisë**.
- Të nxitë e studentët për të kryer punë kërkimore shkencore dhe eksperimentale duke shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni (literaturë bashkëkohore, site interneti, periodikë, manuale didaktike etj) si dhe **laboratorët** e biologjisë dhe kimisë me infrastrukturë bashkëkohore që disponon Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane.

## Teknologji Informacioni

Qëllimi i programit të studimit:

Programi i studimit Master në Teknologji Informacioni ka për qëllim të aftësojë profesionistë me njohuri të avancuara në fushat kryesore të Teknologjisë së Informacionit, të integrojnë zgjidhjet që ofron teknologjia e informacionit me ato të proceseve të biznesit dhe institucioneve të ndryshme për të plotësuar nevojat e tyre për informacion, komunikim duke rritur cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve dhe si rrjedhim duke u mundësuar atyre arritjen e objektivave në një mënyrë efektive dhe efçiente.

Objektivat e programit të studimit, synojnë që studentët pas diplomimit:

- Të zgjidhin probleme të ndryshme duke identifikuar, analizuar, zhvilluar dhe implementuar zgjidhje bazuar në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit.
- Të fitojnë aftësinë për të mirëmbajtur dhe përditësuar sistemet e teknologjive të informacionit dhe komunikimit në biznese dhe institucione të ndryshme duke rritur shkallën e efikasitetit të tyre.
- Të planifikojnë, drejtojnë, organizojnë dhe marrin pjesë në grupe pune dhe projekte në grup që mundësojnë arritjen e zgjidhjeve të suksesshme të sistemeve të informacionit.
- Të kuptojnë funksionet dhe aplikimet e kompjuterëve në mjedisin e sistemeve të informacionit dhe të aplikojnë këto njohuri brenda organizatës, strukturave dhe proceseve të biznesit.
- Të fitojnë aftësinë për të ndërtuar aplikacione në ndihmë të zgjidhjes së problemeve në organizata ose në biznese të ndryshme.
- Të jenë të aftë të implementojnë teknologjitë e reja të internetit në ndihmë të rritjes së efikasitetit dhe transparencës së shërbimeve të institucioneve qeveritare dhe të bizneseve të ndryshme.

## Infermieristikë

Programi i studimit i ciklit të dytë Master Profesional në Infermieristikë ofron mundësi për formim të vazhdueshëm dhe kualifikim të mëtejshëm profesional të gjithë studentëve që kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve në Infermieri të përgjithshme, ose fusha të përafërta, apo të ngjashme me të. Ky program realizohet me 90 kredite me kohëzgjatje 1 vit e gjysëm, 3 semestra. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë: Master i Nivelit të Parë. Forma e studimit: kohë e pjesëshme/kohë e plotë.

Në përfundim të studimeve Master Profesional në Infermieristikë, diplomanti do të jetë i aftë:

- Të aplikojë konceptet, teoritë parimet e shkencës së Infermieristikës, demonstrojë kompetencat në praktikë, praktikojë si një infermier specialist.
- Të demonstrojë cilësitë e liderit dhe të funksionijë në mënyrë të efektshme si edukator dhe menaxher.
- Të demonstrojë aftësi në kryerjen e kërkimit infermieror, në interpretimin dhe shfrytëzimin e përfundimeve të kërkimeve nga fusha e shëndetësisë.
- Të paraqitë aftësi për planifikim dhe ndryshime efektive në praktikën infermirore dhe sistemin e shërbimeve shëndetësore, vendosë marrëdhënie bashkëpunuese me punonjësit e disiplinave të tjera.
- Të shfaqë interes në mësimin e vazhdueshëm për përmirësimin profesional.

## **Administrim Publik**

### **Objektivat akademike**

***e) Shkalla e kualifikimit të stafit kryesor.***

***Të dhëna për personelin e njësisë sipas klasifikimit të zyrës së personelit.***

***Tab. I.1***

Grada shkencore	<i>Departamenti i Shkencave Sociale</i>	<i>Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës</i>	<i>Departamenti i Infermierisë</i>	<i>Departamenti i Biologjisë dhe Kimisë</i>
Prof. dr.	1	1	-	-
Prof. as. dr.	1	-	-	-
Doktor	3	5	2	4
Docent	1	-	1	
Msc.	8	14	8	3
Asistent Pedagog	-	-	-	
<b>GJITHSEJ</b>	<b>14</b>	<b>20</b>	<b>11</b>	<b>7</b>

***ë) Raporti staf i kualifikuar, staf i pakualifikuar.***

***25.5%***

Departamentet me përqindjen më të madhe të stafit efektiv pa tituj dhe grada janë Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës dhe Departamenti i Infermierisë. Sidoqoftë, Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës ka dhe përqindjen më të madhe të doktorantëve, që do të thotë që shumë afër, do të fitojnë gradën doktor një pjesë e madhe e stafit efektiv në këtë departament.

Përsa i përket stafit që nuk është regjistruar në studimet doktorale, përqindjen më të madhe e ka departamenti i Infermierisë, ndërsa përqindjen më të madhe të stafit me tituj dhe grada shkencore e ka departamenti i Biologjisë-Kimisë, i cili përbëhet edhe nga një numër më i vogël pedagogësh krahasuar me departamentet e tjera si dhe në rekrutimet e fundit janë ofruar kandidatë me gradën shkencore “Doktor”.

Për vitin akademik 2016-2017, në total 5 pedagogë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane kanë fituar gradën shkencore “Doktor i Shkencave”.

*f) Raporti staf i brendshëm, staf i jashtëm.*

Nr.	Programet E Studimit	Cikli i Studimit	Raporti Staf		
		Ba, MP, Msc	I Jashtëm / I Brendshëm	Staf/ Student	Femra/ Meshkuj
12.	Filozofi-Sociologji	Ba	1:4.66	1:6.76	1.4:1
13.	Administrim dhe politika sociale	Ba	1:4.25	1:9.95	2.5:1
14.	Mësuesi për arsimin e mesëm në Shkenca Sociale	MP	1:3	1:3.63	1:1.67
15.	Administrim Publik	MP	1:11	1:2	1:1.5

Nr.	Programet E Studimit	Cikli i Studimit	Raporti Staf		
		Ba, MP, Msc	I Jashtëm / I Brendshëm	Staf/ Student	Femra/ Meshkuj
16.	Teknologji Informacioni	Ba	1:9	1: 8.4	1.1:1
17.	Matematikë-Informatikë	Ba	*	1: 5.1	1.3:1
18.	Matematikë-Fizikë	Ba	*	1: 4	2.4:1
19.	Teknologji Informacioni	MP	1:7	1:4.5	1:1.6
20.	Mësuesi në Matematikë dhe Fizikë me profil minor Informatikë	MP	*	1:3.5	1.67:1

\*Nuk ka pedagogë të jashtëm për programet e studimit Bachelor Matematikë-Informatikë dhe Matematikë-Fizikë, si dhe për programin e studimit Master, Mësuesi në Matematikë dhe Fizikë me profil minor Informatikë.

Nr.	Programet E Studimit	Cikli i Studimit	Raporti Staf			
		Ba, MP, Msc.	I Jashtëm / I Brendshëm	Staf/ Student	I Kualifikuar/ I Pakualifikuar	Femra/ Meshkuj
21.	Bachelor Biologji-Kimisë	Ba	1:20	1:6.2	1:1	1.5:1
22.	Master Profesional Mësimdhënie për mësuesit e Biologji-Kimisë	MP	*	1:3.7	*	1.8:1

\*Nuk ka pedagogë të jashtëm për programin e studimit Master Profesional Mësimdhënie për mësuesit e Biologji-Kimisë, për vitin akademik 2016-2017.

Nr.	Programi	Cikli I Studimit Ba, Mp, Msc	Staf Efektiv	Staf I Ftuar	Raporti Staf. Efektiv/ Student	Raporti Staf Total /Student
1.	Infermier i përgjithshëm	Ba	11	24	1 :26	1 : 11
2.	Mami	Ba	11	24	1 :26	1 : 11
3.	Infermieristikw	MP	12	9	1 : 12	1 : 7

*g) Mosha mesatare e stafit mësimdhënës dhe raporti meshkuj-femra.*

*Raporti meshkuj/femra %:*

Meshkuj/Femra	Departamenti i Shkencave Sociale	Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës	Departamenti i Infermierisë	Departamenti i Biologjisë

<i>Meshkuj</i>	46%	55%	23%	20%
<i>Femra</i>	54%	45%	67%	80%

*Të dhëna për shpërndarjen e stafit akademik të brendshëm.*

*Sipas moshës:*

<i>Stafi dhe administrata</i>	<i>(Departamenti i Shkencave Sociale)</i>					<i>(Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës)</i>					<i>(Departamenti i Infermierisë)</i>					<i>(Departamenti i Biologji-Kimisë)</i>				
	<25-35	36 - 45	46-55	56-65	Mbi 65	<25-35	36 - 45	46-55	56-65	Mbi 65	<25-35	36 - 45	46-55	56-65	Mbi 65	<25-35	36 - 45	46-55	56-65	Mbi 65
<b>Prof. dr.</b>				1					1											
<b>Prof. as. dr.</b>				1																
<b>Doktor</b>	2	1				2		3						2		1	2	1		
<b>Docent</b>			1											1						
<b>Msc.</b>	8					1					1	7				3				
<b>Asistent pedagog</b>																				
<b>Staf ndihmës-mësimor</b>																				
<b>Mosha mesatare 37.5 vjeç, staf i kualifikuar/staf i pakualifikuar (25.5 %)</b>																				

*Tabela I.3 (përmbledhëse)*

<i>Stafi dhe administrata</i>	<b>MOSHA</b>				
	<25-35	36-45	46-55	56-65	>65
<b>Prof. dr.</b>				2	
<b>Prof. as. dr.</b>				1	
<b>Doktor</b>	5	3	6		
<b>Docent</b>			2		
<b>Msc.</b>	26	7			
<b>Asistent pedagog</b>					
<b>Staf ndihmës-mësimor</b>					
<b>Mosha mesatare 37.5 vjeç, staf i kualifikuar/staf i pakualifikuar (25.5 %)</b>					

Numri i pedagogëve efektivë dhe të ftuar për vitin akademik 2016-2017

Tab. III.1

Programet e Studimit	Cikli i studimit (Ba, MP, Msc)	Forma e studimit KP/KPj	B	J
Filozofi-Sociologji	Ba	KP	14	6
Administrim dhe politika sociale	Ba	KP	14	7
Matematikë-Informatikë	Ba	KP	18	2
Matematikë-Fizikë	Ba	KP	17	3
Teknologji-Informacioni	Ba	KP	22	2
Biologji-Kimi	Ba	KP	7	4
Infermier i Përgjithshëm	Ba	KP	11	24
Mami (Infermier)	Ba	KP	11	24
Infermier i Përgjithshëm	Ba	KPj	11	3
Mësuesi për arsimin e mesëm në shkenca sociale me profil minor në "Edukim Qytetar dhe Demokratik"	MP	KP	5	13
Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Matematikë - Fizikë me profil minor në "Informatike"	MP	KP	15	3
Teknologji-Informacioni	MP	KP	12	3
Mësimdhënie për mësuesit e Biologji Kimisë	MP	KP	13	2
Infermieristikë	MP	KP	15	5

Programet e Studimit	Cikli i studimit (Ba, MP, Msc)	Forma e studimit KP/KPj	B/B	B/J	J/J
Filozofi-Sociologji	Ba	KP	14	3	6
Administrim dhe politika sociale	Ba	KP	14	4	3
Matematikë-Informatikë	Ba	KP	18	1	1
Matematikë-Fizikë	Ba	KP	17	2	1
Teknologji-Informacioni	Ba	KP	15	7	2
Biologji-Kimi	Ba	KP	10	6	4
Infermier i Përgjithshëm	Ba	KP	11	6	20
Mami (Infermier)	Ba	KP	11	6	16
Infermier i Përgjithshëm	Ba	KPj	11	1	3
Mësuesi për arsimin e mesëm në shkenca sociale me profil minor në "Edukim Qytetar dhe Demokratik"	MP	KP	5	7	6
Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Matematikë - Fizikë me profil minor në "Informatike"	MP	KP	8	7	3
Teknologji-Informacioni	MP	KP	9	3	3
Mësimdhënie për mësuesit e Biologji Kimisë	MP	KP	6	7	2
Infermieristikë	MP	KP	11	4	5

Tab. III.2

**Realizimi i orëve B/J.**

<b>Programe Studimi</b>	<b>Cikli i studimit (Ba, MP, Msc)</b>	<b>Forma e studimit KP/KPj</b>	<b>Pedagogë me kohë të plotë</b>	<b>Pedagogë të ftuar</b>
Filozofi-Sociologji	<b>Ba</b>	<b>KP</b>	<b>2509.3</b>	<b>385</b>
Administrim dhe politika sociale	<b>Ba</b>	<b>KP</b>	<b>2952.4</b>	<b>390</b>
Matematikë-Informatikë	<b>Ba</b>	<b>KP</b>	<b>2974.9</b>	<b>90</b>
Matematikë-Fizikë	<b>Ba</b>	<b>KP</b>	<b>2517.2</b>	<b>90</b>
Teknologji-Informacioni	<b>Ba</b>	<b>KP</b>	<b>2518.4</b>	<b>587</b>
Biologji-Kimi	<b>Ba</b>	<b>KP</b>	<b>3121.2</b>	<b>378.5</b>
Infermier i Përgjithshëm	<b>Ba</b>	<b>KP</b>	<b>2645</b>	<b>1578</b>
Mami (Infermier)	<b>Ba</b>	<b>KP</b>	<b>1883</b>	<b>671</b>
Mësuesi për arsimin e mesëm në shkencë sociale me profil minor në "Edukim Qytetar dhe Demokratik"	<b>MP</b>	<b>KP</b>	<b>758.8</b>	<b>508</b>
Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Matematikë - Fizikë me profil minor në "Informatikë"	<b>MP</b>	<b>KP</b>	<b>1154</b>	<b>340</b>
Teknologji-Informacioni	<b>MP</b>	<b>KP</b>	<b>914</b>	<b>330</b>
Mësimdhënie për mësuesit e Biologji Kimisë	<b>MP</b>	<b>KP</b>	<b>1519</b>	<b>162</b>
Infermieristikë	<b>MP</b>	<b>KP</b>	<b>1366</b>	<b>303</b>

## VII - KËRKIMI SHKENCOR

### B. Kualifikimi shkencor

Mbrojtja e gradave dhe titujve shkencorë

<i>Departamentet</i>				
<i>Titujt/gradat</i>	<i>Shkencave Sociale</i>	<i>Matematikës, Informatikës dhe Fizikës</i>	<i>Infermierisë</i>	<i>Biologji-Kimi</i>
Doktor	2	2	-	1
Prof.as	-	-	-	-
Prof. dr.	-	-	-	-

### A. Kërkimi shkencor

Tabela përmbledhëse për rezultatet e periudhës Shtator 2016 – Shtator 2017

FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE						
NR.	EMËRTIMI	DEPARTAMENT I I SHKENCAVE SOCIALE	DEPARTAMENTI I MATEMATIKËS, INFORMATIKËS DHE FIZIKËS	DEPARTAMENTI I BIOLOGJIKIMISË	DEPARTAMENTI I INFERMIERISË	TOTAL
1.	KONFERENCA	22	23	6	4	55
2.	TEKSTE	-	1	-	1	2
3.	MONOGRAFI	-	1	-	-	1
4.	DISPENSA	-	3	-	5	8
5.	ARTIKUJ	17	11	8	7	43
6.	PUBLIKIME	2	5	-	-	7
7.	ËORKSHOP	7	2	-	1	10
8.	TRAJNIME	-	-	-	2	2
9.	LEKTORIUM	-	7	-	-	7
TOTAL SIPAS DEPARTAMENTEVE		48	53	14	20	135

Vihet re një pjesëmarrje e kënaqshme e pjesëtarëve të Departamenteve në Konferenca Ndërkombëtare, si dhe në botime artikujsh.

Nuk janë realizuar shumë botime tekstesh apo monografish nga Departamentet.

Një mangësi që vihet re është organizimi i veprimtarive shkencore nga Departamentet, ku me përjashtim të Departamentit të Shkencave Sociale, mungojnë organizimet nga Departamentet e tjera të Fakultetit.



## VIII - STUDENTËT

### a- Kriteri i pranimit të studentëve.

Niveli cilësor i pranimeve karakterizohet në përgjithësi nga njënotë mesatare në rritje, për një numër të caktuar programesh studimi, krahasuar me vitet e mëparshme. Mesatarja më e lartë është nota 10, në programet e studimit Matematikë-Informatikë dhe Biologji-Kimi, ndërsa nota mesatare më e ulët është 6 në të gjitha programet, me përjashtim të programit të studimit Biologji – Kimi, që është 6.5.

Nota mesatare e përgjithshme (për gjithë kursin) më e lartë është 8.8 për programin e studimit Matematikë-Informatikë, ndërsa më e ulta është 6.5 për programin e studimit Mami.

### b- Zhvillimi i studimeve.

### c- Vlerësimi i studentëve.

### d- Praktika profesionale.

### e- Planet mësimore.

### f- Mbrojtja e diplomës.

**Tab. VI.2 Gjeografia e pranimit të studentëve.**

VITI AKADEMIK 2016 – 2017			
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE	ZONA RURALE	ZONA URBANE	GJITHSEJ
Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës	55	89	144
Departamenti i Shkencave Sociale	33	87	120
Departamenti i Biologji-Kimisë	28	40	68
Departamenti i Infermierisë	96	111	207

**Shpërndarja gjeografike e pranimit të studentëve sipas programeve të studimit për vitin akademik 2016-2017.**

FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE	RRETHET									
	KORÇË	DEVOLL	KOLONJË	POGRADEC	LIBRAZHD	GRAMSH	SKRAPAR	TIRANË	TJETËR	GJITHSEJ
Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës	109	8	2	15	-	-	-	-	10	144
Departamenti i Shkencave Sociale	97	3	1	12			1	1	5	120
Departamenti i Biologji Kimisë	47	7		7					7	68
Departamenti i Infermierisë	127	11	10	45		1			13	207

## BURIME MATERIALE. LOGJISTIKA

1. Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane me një sipërfaqe trualli prej 10251 m<sup>2</sup>; zhvillon veprimtarinë mësimore dhe shkencore në dy godina, godinën e re (ish-Divizioni) dhe godinën ekzistuese të Shkollës së Infermierisë.

Godina qendrore me sipërfaqe 772.8 m<sup>2</sup> (dy kate) disponon 3 salla leksionesh me kapacitet 50-80 vende, 6 klasa seminaresh me kapacitet 30-40 vende dhe 1 amfiteatër me kapacitet 140 vende. Godina e dytë është bibliotekë dhe qendër interneti për studentët. Në godinën qendrore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane ndodhen 7 laboratorë:

Laboratori i Biologjisë

Laboratori i Kimisë

2 laboratorë të Informatikës

2 laboratorë të Fizikës, të ngritur në 2 ambiente

### 2. Pajisjet

Nr.	Teknologji kompjuterike	Njësia (në copë)
1.	Numri i PC për stafin akademik	57
2.	Numri i printerëve për stafin akademik	10
3.	Numri i PC për administratën	11
4.	Numri i printerëve për administratën	5
5.	Numri i PC për bibliotekën	11
6.	Nr. i PC për studentët (salla e kompjuterëve)	15
7.	Numri i printerëve për studentë	-
8.	Numri i PC për auditor mësimor	66
9.	Numri i projektorëve për auditor mësimor	19
10.	Numri i skanerëve	4
11.	Numri i fotokopjeve	5

### Tabelë përmbledhëse

Nr.	Teknologji kompjuterike	Totali (në copë)
1.	PC	137
2.	Kompjuterat portative	23
3.	Printerat	15
4.	Skanera	4
5.	Fotokopje	5
6.	Projektorë	19

### 3 Biblioteka

LIBRA DHE TITUJ	SIPAS KLASIFIKIMIT LËNDOR	LIBRI SHQIP DHE I HUAJ	BLERJET DHE DHURIME (TITUJ)
-----------------	---------------------------	------------------------	-----------------------------

TITUJ	LIBRA	Filozofi Sociologji	Biologji Kimi	Infermieri	Matematike	SHQIP	I HUAJ	BLERJE	DHURIME
1031	10592	121	17	9909	93	9048	1544	1484 868 tituj	9108 163 tituj

#### ***X - FINANÇIMI DHE MENAXHIMI I BURIMEVE FINANCIARE***

<b>Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare</b>			
<b>Nr.</b>		<b>Viti</b>	<b>Viti</b>
1.	Projekte të fituar MASH	-	-
2.	Grande CBA	-	-
3.	Investime	-	-
4.	Fonde jo publike, grande CBA	-	-
5.	Sponsorizime	-	-

#### **XI - SISTEMI I BRENDSHËM I SIGURIMIT TË CILËSISË**

Përshkrim i funksionimit të NjBSC-ve;

Krijimi i grupit të Vlerësimit të Brendshëm përbëhet nga anëtarë të stafit akademik dhe administrativ me kohë të plotë, si dhe një përfaqësues i studentëve. Synimi i grupit të Vlerësimit të Brendshëm është t'i paraqesë Grupit të Vlerësimit të Jashtëm një shqyrtim analitik të gjendjes aktuale dhe perspektivat e zhvillimit të Universitetit "Fan S. Noli".

Dekani është autoriteti më i lartë drejtues i fakultetit. Detyrat dhe kompetencat e tij përcaktohen në Statutin e UK-së.

Përgjegjësi i Departamentit përgjegjësi i departamentit është autoriteti më i lartë drejtues për Departamentin, njësia bazë mësimore dhe shkencore. Detyrat e kompetencat e tij janë të përcaktuara në Statusin e UK-së.

#### **XII - BASHKËPUNIMI KOMBËTAR, NDËRKOMBËTAR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN**

*a. Bashkëpunimi kombëtar*

*b. Bashkëpunimi ndërkombëtar*

### XIII. ANALIZA SWOT E FAKULTETIT . . .

Ndryshe nga vitet e kaluara Analiza SËOT do të trajtohet në një mënyrë tjetër pasi duke marrë për bazë të dhënat e analizës së vitit të kaluar do të paraqiten:

Si u përdorën pikat e forta në ngritjen e strategjive e uljes së rreziqeve dhe përmirësimit të pikave të dobëta;

Cilat janë strategjitë e mundshme në përmirësimin e pikave të dobëta të evidentuara. (sugjerime);  
Sa ndikim kanë mundësitë e jashtme potenciale në rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e dobësive;  
Strategji të shmangies së rreziqeve të jashtme potenciale.

#### ANALIZA SWOT

Pikat e forta të brendshme potenciale	Pikat e dobëta të brendshme potenciale
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Mjedise dhe infrastrukturë bashkëkohore</b> për një zhvillim normal të punës mësimore dhe kërkimore-shkencore në Fakultet. Infrastruktura në dispozicion të FSHNH është e mjaftueshme për të siguruar kushte të kënaqshme pune për studentët dhe pedagogët. Kushtet e mësimdhënies: ngrohje-ftohje-ventilim-ndriçim si dhe mjetet audiovizive, kompjuterat, videoprojektorët, tabelat, bankat, karriget etj, në mjaft auditorë janë konform me kërkesat bashkëkohore.</li> <li>• <b>Stabiliteti strukturor i FSHNH.</b> Nga pikëpamja e organizimit strukturor, të potencialeve njerëzore dhe të potencialeve drejtuese FSHNH ka njohur qëndrueshmëri të strukturave të saj si të njësisive bazë dhe atyre administrative, ashtu edhe të organeve të saj kolegjiale. FSHNH dhe departamentet e saj plotësojnë kriteret e vendosura nga Ligji i Arsimit të Lartë për organizimin strukturor të një Institucioni të Arsimit të Lartë.</li> <li>• <b>Laboratorët</b> e kimisë, biologjisë, infermieristikës, fizikës, informatikës etj të pajisur me bazën e duhur laboratorike për zhvillimin e orëve të laboratoreve janë një pikë e fortë për realizimin e objektivave të procesit mësimor.</li> <li>• <b>Bashkëpunimi kombëtar e ndërkombëtar dhe pjesëmarrja në projekte.</b> Lidhjet e Universitetit dhe FSHNH me universitete të tjera homologe në vende te Europës se Itali,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjatë punës së vlerësimit të brendshëm të FSHNH u konstatua se duhet përmirësuar raporti pedagog-student dhe pedagog i brendshëm - pedagog i jashtëm.</li> <li>• Mungesa e literaturës bashkëkohore në bibliotekë dhe mosshfrytëzimi i literaturës ekzistuese nga studentët në shkallën e duhur.</li> <li>• Përqindje e ulët e punësimit të të diplomuarve në pjesën më të madhe të programeve të studimit të ofruara nga FSHNH, për shkak të papunësisë në rritje. (me përjashtim të programeve Matematikë – Informatikë, Matematikë-Fizikë dhe Biologji – Kimi, ku përqindja e të punësuarve është mjaft e lartë)</li> <li>• Duhet të vazhdojë puna e nisur për përmirësimin e kurrikulave, duke i lidhur më tepër me kërkesat e tregut të punës dhe pajisjen e studentëve me kompetenca.</li> <li>• Duhet të realizohet rritja e cilësisë së mësimdhënies duke shfrytëzuar më mirë bazën materiale dhe didaktike në dispozicion të stafit dhe studentëve.</li> <li>• Labororet funksionale të Fizikës, Biologji-Kimisë dhe Labororet në përdorim të Departamentit të Infermierisë, vazhdojnë të jenë një pikë e fortë e Fakultetit, që ndikon fuqishëm në një formim akademik më të mirë të studentëve si dhe në dobi të veprimtarisë kërkimore.</li> <li>• Duhet të synohet më tepër në rritjen e mëtejshme të produktivitetit të metodave të të nxëniet si dhe zhvillimi më i mirë dhe i kontrolluar i praktikave profesionale.</li> <li>• Të aplikohen rezultatet e përfuara nga studimi i tregut i kryer nga disa departamente, për përmirësimin e kurrikulave, ristrukturimin e</li> </ul>

<p>Francë, Gjermani, Belgjikë, Vendet Nordike, Greqi, Maqedoni, etj ka mundësuar jo vetëm krijimin e kushteve për kualifikimin dhe shkëmbimin e eksperiencës së stafit akademik, por edhe bashkëpunim në drejtim të realizimit të programeve të studimit të cikleve të ndryshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë.</b> Cilësia e veprimtarisë së FSHNH garantohej nëpërmjet një sistemi të brendshëm, të përbërë nga strukturat organizative të Universitetit F. S. Noli dhe të Fakultetit. Ngritja e sistemit të sigurimit të cilësisë të përbërë nga Grupet e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë në të gjitha nivelet (departament, fakultet dhe rektorat). Përpilimi i raporteve të vlerësimit të brendshëm për çdo vit akademik është kthyer në një metodë pune të përvitshme. Nëpërmjet këtij sistemi dalin në pah dobësitë, të metat, vështirësitë, por edhe arritjet, sukseset dhe përmirësimet e vazhdueshme që realizohen vit pas viti.</li> <li>• <b>Format demokratike të zgjedhjes të organeve kolegjiale dhe drejtuesve të njësisë kryesore dhe njësisë bazë,</b> forcimi i organeve kolegjiale, si dhe ndërgjegjësimi gjithnjë e më shumë për të sjellë në krye të drejtimit njerëzit me programet më të mira për zhvillimin e njësisë është një pikë e fortë që garanton një udhëheqje sa më kolegjiale të njësisë.</li> <li>• <b>Përfshirja e studentëve në vendim-marrje.</b> Organizimi i studentëve nëpër Këshillat studentore, përfaqësimi i tyre në të gjitha organet kolegjiale, përfshirja e studentëve në procesin e hartimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit, organizimi i aktiviteteve të ndryshme studentore që nga seminare shkencore deri në aktivitete sportive, bashkëpunimi i vazhdueshëm i drejtuesve të FIM me këshillin studentor, etj janë procese të cilat rriten e përmirësohen vazhdimisht duke ndikuar në forcimin e zërit të studentëve dhe rritjen e rolit të tyre aktiv në procesin e vendimmarrjes.</li> <li>• <b>Organizimi i studimeve në FSHNH (cikli i parë, cikli i dytë) është në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë,</b> duke</li> </ul>	<p>programeve ekzistuese apo të kryhet aplikimi për çeljen e programeve të reja të studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Strategjitë e ndjekura nga disa departamente, kanë çuar në përmirësimin e raportit staf-student krahasuar me vitet e mëparshme.</li> <li>• Të përpilohen strategji nga departamentet për të përfshirë studentët në veprimtari të ndryshme kulturore, sociale dhe shkencore, për të shmangur praninë e paket të këtyre lloj aktiviteteve në pjesën më të madhe të departamenteve.</li> <li>• Zhvillimi i infrastrukturës, bibliotekës dhe mjediseve për të mbështetur procesin akademik si dhe për të gjallëruar jetën studentore.</li> <li>• Të rritet bashkëpunimi, aplikimi dhe pjesëmarrja në Projekte Kombëtare dhe Ndërkombëtare nga ana e departamenteve, duke nxitur trajnimin dhe rritur nivelin e ekspertizës së aplikimeve.</li> <li>• Hartimi i strategjive nga ana e departamenteve për përthithjen e studentëve cilësorë.</li> <li>• Thellimi i mëtejshëm i punës organizative të departamenteve mbi bazën e kërkesave që ka aktiviteti kërkimor.</li> <li>• Rritja e mëtejshme e kualifikimeve të stafit akademik.</li> <li>• Angazhim më i madh i stafit akademik në aktivitete shkencore dhe botuese. Të nxitet dhe përkrahet stafi në hartimin e teksteve mësimore për studentët.</li> <li>• Vazhdimësi në thellimin e punës kërkimore me studentët nëpërmjet komunikimit të rezultateve të kërkimit në Fakultet si dhe të trajnimit të tyre me konceptet dhe parimet e etikës në kërkim.</li> <li>• Intensifikim i punës kërkimore dhe kualifikuese të stafit akademik, nëpërmjet projekteve të kërkimit në kuadër të doktoraturës, botimeve të artikujve shkencorë në organe me autoritet shkencor si dhe pjesëmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.</li> <li>• Përkrahja e nismave të departamenteve për zhvillimin e aktiviteteve shkencore në Fakultet.</li> <li>• Të rritet organizimi i seminareve, simpoziumeve apo workshop nga departamentet, ku të krijohet mundësia dhe e paraqitjes së punimeve më të mira nga studentët e Fakultetit.</li> <li>• Mbështetja e kërkuesve të rinj, duke shfrytëzuar të gjithë hapësirën ligjore në dispozicion dhe kapacitetet e brendshme akademike për t'i përfshirë në programet kërkimore të departamenteve.</li> </ul>
--	---

<p>përgatitur specialistë me kualifikime të ndryshme në fushat dhe programet tona, nga niveli Bachelor deri në nivelin e Masterit shkencor duke rritur mundësitë e realizimit të mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik, lehtëson kushtet e njohjes së diplomave tona në vendet e Bashkimit European dhe krijon të gjitha shanset e bashkëpunimit me Universitete partnere për realizimin e ciklit të tretë të studimeve si dhe një pjesë të ciklit të dytë.</p> <p><b>Krijimi i qëndrës së Ekselencës si njësi bazë, kërkimore dhe trajnuese.</b> Në FSHNH funksionon edhe Qendra e Ekselencës, e cila përbën një njësi bazë, kërkimore dhe trajnuese. Kjo qendër ka si mision të vetin, formimin cilësor të specialistëve në fushat përkatëse dhe promovimin e kërkimit shkencor në shkencat e natyrës dhe ato humane. Ajo funksionon si njësi trajnuese dhe kërkimore në fushën e Didaktikës së Shkencave, e certifikuar dhe akredituar nga MASH.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përfshirja intensive e stafit në kualifikimet pasuniversitare.</b> Stafi akademik i FSHNH është përfshirë intensivisht në kualifikime pasuniversitare, gati 47% e stafit akademik janë në proces doktorature duke krijuar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri në cilësinë e stafit mësimdhënës.</li> <li>• <b>Programe në përputhje me nevojat rajonale, kërkesës së tregut dhe më gjerë.</b> FSHNH ofron programe bashkëkohore dhe të kërkuara nga tregu rajonal, kombëtar dhe më gjerë. Programet e ofruara krijojnë mundësi për afrimin e studentëve nga gjithë rajoni juglindor i vendit por dhe më gjerë. Kjo vihet re në plotësimin e kuotave për regjistrim dhe në shtimin e kërkesës për shkollim.</li> <li>• <b>Aplikimi i filozofisë interaktive të arsimit të lartë dhe aplikimi i metodave të reja të mësimdhënies.</b> Në FSHNH aplikohet filozofia interaktive e arsimit të lartë ku në qendër të sistemit vendoset studenti i cili punon mbi bazën e objektivave dhe është aktiv gjatë zhvillimit të procesit mësimor, i cili zhvillohet nëpërmjet metodave të reja të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Duhet më shumë bashkëpunim në nivel lokal dhe kombëtar me institucionet përkatëse, me qëllim punësimin e studentëve më cilësorë.</li> <li>• Mungesa e një databaze për punësimin e studentëve të diplomuar në vite.</li> <li>• Mungesa e një mjedisi të përshtatshëm sportiv në Fakultet.</li> <li>• Mungesa e autonomisë financiare për Fakultetin dhe Departamentin.</li> <li>• Duhet të përmiresohen instrumentat dhe metodat e vlerësimit të studentëve.</li> <li>• Duhet të përmirësohet në vazhdimësi cilësia e programeve, e mësimdhënies dhe e formimit të studentëve.</li> </ul>
---	--

<p>mësimdhënies kryesisht audiovizuale dhe pedagogjike interaktive që nxitin punën e pavarur dhe formimin (vlerësimi formues) e studentit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Pozicioni gjeografik i Universitetit F. S. Noli dhe FSHNH.</b> Vendndodhja gjeografike e Universitetit F. S. Noli si qëndër universitare për gjithë rajonin juglindor të Shqipërisë dhe në kufi me dy shtete ballkanike ofron mundësi për përthithjen e studentëve të rajonit dhe më gjerë si dhe për shkëmbim përvojash në fushën e edukimit dhe kërkimit shkencor.</li> <li>• <b>Mosha e re e stafit akademik</b>  Duke qenë se mosha mesatare e stafit akademik është 38 vjeç, krijohen mundësi për kualifikime të mëtejshme.</li> <li>• <b>Misioni dhe objektivat e Fakultetit</b> janë objektive, në përshtatje me kapacitetet e fakultetit dhe të realizueshme. Stafi akademik njihet dhe punon në drejtim të realizimit të tyre dhe informon rregullisht studentët dhe përfaqësuesit e tyre mbi arritjet dhe ndryshimet (përmirësimet) në këtë drejtim.</li> <li>• <b>Lidhja me internet</b> në çdo ambjent zyre dhe për çdo anëtar të stafit të Fakultetit, krijimi i regjistrit elektronik për studentët, informimi i tyre në kohë reale elektronike mbi objektivat, programet e lëndëve, rezultatet në provime ka krijuar kushte për përmirësimin e urave të komunikimit ndërmjet niveleve të ndryshme të strukturave të Fakultetit si dhe midis pedagogëve dhe studentëve.</li> </ul>	
<b>Mundësitë e jashtme potenciale</b>	<b>Rreziqet e jashtme potenciale</b>
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Një pjesë e dobësive të konstatuara që kanë lidhje me punën e stafit akademik dhe me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në Fakultet janë plotësisht të menaxhueshme nëpërmjet vendosjes të prioritetëve dhe me gatishmërinë e organeve drejtuese të Fakultetit dhe Universitetit. Duke parë ndryshimet dhe përmirësimet e bëra si në infrastrukturë ashtu edhe në mënyrën e menaxhimit dhe drejtimit të institucionit, themi se stafi akademik dhe organet</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndryshimet e shpeshta të kuadrit ligjor ndikojnë negativisht në veprimtarinë e Institucioneve të Arsimit të Lartë, pasi përshtatja me ndryshimet e reja kërkon kohë dhe harxhim të energjive njerëzore dhe të drejtimit, ndikon në uljen e efektivitetit të veprimtarisë së përgjithshme të institucionit, dhe sjell konfundime tek stafi akademik dhe studentët, pasiguri për të ardhmen, vështirësi në menaxhimin e periudhave të tranzicionit, etj.</li> </ol>

<p>drejtuese kanë kualifikimet dhe eksperiencën për të bërë përmirësimet përkatëse aty ku vihen re pika të dobëta.</p> <p>2. Politikat e ndjekura nga qeveria për plotësimin e universiteteve me stafit akademik efektiv është në përputhje me nevojat tona për staf të ri akademik. Është në dorë të drejtimit që të gjurmohet dhe të përzgjedhë kandidaturat më të mira nga ana cilësore si dhe në moshë relativisht të re.</p> <p>3. Kuadri ligjor aktual për arsimin e lartë, krijon mundësi për forcimin e demokracisë në jetën universitare, për ndarjen sa më mirë të përgjegjësisë, rritjen e përgjegjshmërisë së organeve drejtuese të institucionit në menaxhimin e burimeve njerezore, materiale e financiare të institucionit.</p> <p>4. Marrëdhëniet e ngushta me institucionet arsimore qendrore dhe lokale në funksion të realizimit të kualifikimeve të synuara.</p> <p>5. Zbatimi në praktikë e autonomisë financiare, e cila duhet të shtrihet deri në nivel departamenti, krijimi i rregullave të brendshme për mënyrën e menaxhimit dhe të kontrollit të shpenzimeve, do të rrisë më shumë autonominë e njësisë duke përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, aktivitetin shkencor dhe laboratorët mësimor e shkencor të Fakultetit.</p> <p>6. Bashkëpunimi midis institucioneve të arsimit të lartë në vend dhe jashtë tij, përbën një mundësi për shkëmbim eksperience, ekspertize, informacioni, dijesh, teknologjish dhe burimesh njerezore, por njëkohësisht ajo shërben edhe si një mundësi për reflektim e përmirësim të vazhdueshëm.</p> <p>7. Proçeset integruese, projektet e përbashkëta në të cilat është përfshirë Universiteti ynë, krijojnë mundësi të mëdha për zgjerimin e bashkëpunimit me institucione brenda e jashtë rajonit dhe më gjerë, në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor. Pjesëmarrja në to e sa më shumë anëtarëve të stafit akademik dhe drejtues synon përmirësimin e cilësisë, kualifikimin e vazhduar dhe shkëmbimin e eksperiencave pozitive reciproke.</p> <p>8. Kualifikimi i vazhduar i stafit akademik mbi metodologjinë e projekteve, gjuhën e huaj,</p>	<p>2. Implementimi i një sistemi të qëndrueshëm menaxhimi për sigurimin e cilësisë në universitet dhe fakultet përbën një domosdoshmëri për të ardhmen. Rritja e shkallës së demokratizimit të jetës universitare dhe implementimi i një autonomie reale si akademike, ashtu edhe financiare e pashoqëruar me rregulla dhe procedura të miratuara si dhe me mjetet e kontrollit të tyre do të sillte vetëm anarshi dhe përkeqësim të gjendjes.</p> <p>3. Mosndjekja e tregut të punës dhe e tendencës së zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri, rajon e më gjerë, dhe mosreflektimi i ndryshimeve në filozofinë, strategjinë, menaxhimin e institucionit, kurrikulat, programet e lëndëve, dhe gjithë dokumentacionin ku mbështetet veprimtaria e fakultetit, rrezikon të vendosë në vështirësi rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të institucionit.</p> <p>4. Rritja e vazhdueshme e numrit të studentëve pa marrë në konsideratë kushtet infrastrukturore të fakultetit, përbën një kërcënim për të ardhmen, pasi mungesa e hapsirave dhe mjediseve të punës për studentët ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë në dalje.</p> <p>5. Cilësia jo e kënaqëshme studentëve në hyrje janë një kërcënim për sigurimin e cilësisë në dalje.</p> <p>6. Mungesa e një tregu të gjerë punësimi në nivel rajonal, mungesa e të dhënave mbi punësimet në nivel rajonal e më gjerë krijon vështirësi në orientimin e programeve të studimit dhe në përcaktimin e kuotave në cdo program.</p>
---	---



<p>teknologjinë e informacionit, metodikën e mësimdhënies ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së brendshme si dhe veprimtarisë akademike kërkimore, shkencore dhe mësimore të programeve të studimit.</p> <p>9. Promovimi i aktivitetit kërkimor në nivel departamenti mund të përmirësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nëpërmjet organizimit të konferencave, simpoziumeve dhe seminareve</li> <li>• Nëpërmjet pjesëmarrjes së departamentit në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare:</li> <li>• Nëpërmjet realizimit të botimeve për pedagogët në fazë doktorale dhe mbrojtje të titullit akademik:</li> <li>• Nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet rajonale lokale e më gjerë.</li> </ul> <p>10. Ngritja e Qendrës së Karrierës në Universitet do të përmirësojë lidhjet e institucionit me studentët, do të krijojë kushtet për ngritjen e një databaze për studentët dhe për punësimin e tyre, për formimin e vazhduar etj.</p>	
--	--